



REGJISTRIMI I BASHKESIAVE DHE GRUPEVE
KOMUNA E OBILIQIT-OPSTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OSTE ADMINISTRACIJE



Dalës-izleznja

Nr. XIV-93
Br.

Data 06.06.2019
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova

Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

THIRRJE PUBLIKE

I.-Për të gjithë individët, organizatat jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë në Komunën e Obiliqit, programi i të cilave është i fokusuar në fushë veprimtaritë e kulturës, rinisë dhe sportit dhe që përfshin aktivitete të realizuara në Komunën e Obiliqit të aplikojnë për mbështetje financiare:

➤ NË FUSHË VEPRIMTARITË E KULTURËS/ PROMOVIMI DHE AFIRMIMI I VLERAVE KULTURORE

- Kultivojnë dhe promovojnë krijimtaritë vendore lokale;
- Nxisin pjesëmarrjen e audiencave të reja në jetën kulturore, këndim, lojëra, skeçe humoristike;
- Promovojnë traditat përmes artit nga trashëgimia popullore;
- Promovojnë traditat nga gastronomia lokale;
- Promovojnë diversitetin lokal kulturor dhe nxisin dialogun artistik ndërkulturor ;
- Kontribuojnë në zhvillimin e turizmit kulturor lokal;
- Promovojnë vlerat krijuese letrare përmes aktiviteteve të ndryshme;
- Festivalet, manifestime, panairë, shënimet e datave kulturore-historike, simpoziumet dhe ekspozitat ;

➤ **NË FUSHË VEPRIMTARITË E ÇËSHTJEVE RINORE/ PËRKRAHJA DHE FUQIZIMI I RINISË**

- Mbështetja dhe fuqizimi i organizatave rinore në zhvillimin e aktiviteteve specifike për të rinjtë që ndikojnë drejt për së drejti në nxitjen e aktiviteteve në fushë veprimtaritë e çështjeve rinore, përfshirë Strategjinë Kosovare për Rini dhe Plan të Veprimit;
- Të kontribuojë në inkorporimin e jetës shoqërore të qytetarëve të Komunës së Obiliqit dhe në veçanti të vajzave dhe grave, duke ofruar kështu programe educative sidomos çështjet gjinore dhe të shëndetit, si dhe pjesëmarrjes në iniciativat e ndryshme të avokimit dhe lobimit
- Mbështetje të personave me nevoja të veçanta dhe programe inovacionesh nga fusha e teknologjisë

➤ **NË FUSHË VEPRIMTARITË SPORTIVE**

- Zhvillimi dhe afirmimi i sportit në Komunën e Obiliqit
- Masivizimi i sportit për të rinj
- Mbështetja dhe përkrahja e klubeve sportive dhe sportistëve individual
- Organizimi i aktiviteteve sportive për qëllime edukative
- Projekte të ndryshme me karakter sportive me grup-mosha të ndryshme
- Ngritja e nivelit profesional të klubeve sportive

II. Me vendim të kryetarit të komunës, vlerësimi i projekteve do të bëhet nga një komision profesional 3-anëtarësh, detyra e të cilëve është që t'i vlerësojnë projektet në bazë të kriterëve për vlerësim dhe sipas rregullorës për kushtet, kriteret dhe proceduarat e ndarjes së subvencioneve.

VLERËSIMI DO TË BËHËT SIPAS:

1. Rregullësisë dhe plotësimi të kushteve administrative të aplikimi
2. Ndërlidhjes me objektivat e thirrjes
3. Kapacitetit dhe performancës së dëshmuar organizativ dhe menaxhues
4. Vazhdimësisë së realizimit të programit dhe qendrueshmërisë së tij
5. Njohjes ose kontributit për afirmimin ndërkombëtar të qytetit të Obiliqit
6. Cilësisë dhe përmbajtjes së projektit
7. Originalitetit të projektit

III. Dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarje të subvencioneve janë;

- Projekt propozimi ;
- Aplikacioni;
- Dokumenti identifikues;
- Certifikatë e vendbanimit (për persona fizik);
- Certifikatë e regjistrimit (për persona juridik);
- Dëshmi për pagesën e tatimit pronë (për persona fizik dhe juridik)
- Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së (për persona juridik);
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;

IV. Formulari për aplikim mund të merret në zyrën pritëse, në katin e parë të objektit komunal.

Dokumentacioni për konkurim dorëzohet në të njëjtën adresë (zyrën pritëse)

Vërejtje!

Kjo thirrje publike nuk krijon mundësi aplikimi për OJQ-të e subvencioneve të cilët janë shpallur përfitues në thirrjen e parë publike të shpallur nga DKRS-ja për vitin 2019.

Aplikacionet e arritura pas afatit nuk do të shqyrtohen, kurse dokumentacioni i pakompletuar do të refuzohet. Përfituesit e projekteve në vitin e kaluar, të cilët nuk kanë sjell raportet financiare, dhe narrative nuk do të shqyrtohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në ueb-faqën e komunës dhe në hapësirat publike në territorin e komunës së Obiliqit.

Qershor 2019, Obiliq

Drejtoresha e DKRS

Ilirë Kelmendi Shema

